

Shtojca V e kësaj Marrëveshje Financimi

Specifikime minimale të Sistemit të Kontabilitetit me Bazë Akruale/Shtimi

Sistemi i kontabilitetit të përfituesit të IPA II duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

1. Të reflektojë strukturën organizative të caktuar për sistemet e kontrollit të brendshëm të përshtatur për kryerjen e detyrave. Në mënyrë të veçantë, para se të autorizohet një veprim, duhet të verifikohen të gjitha aspektet (si operative dhe financiare) e veprimit nga anëtarët e tjerë të stafit, përveç atij që e ka nisur veprimin. Personi që merret me verifikimin nuk mund të jetë në varësi të atij që e ka nisur transaksionin.
2. Të përfshijë një gjurmë auditimi për të gjitha transaksionet dhe ndryshimet.
3. Të ketë siguri të mjaftueshme fizike dhe elektronike, duke përfshirë sistemet e rikuperimit dhe të ruajtjes së një kopje rezervë/mbështetjes.
4. Sistemi i kontabilitetit duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm për kontratat lokale që menaxhohen nën secilin program:
 - a. Referencën e Kontratës;
 - b. Vlerën e kontratës, duke përfshirë çdo ndryshim;
 - c. Datat e nënshkrimit të kontratës (nga të dyja palët);
 - d. Datën e fillimit të zbatimit të kontratës;

Kjo është përveç datës së nënshkrimit të kontratës dhe mund të jetë e ndryshme nga ajo, si në rastet kur data e fillimit të punimeve të kontratës jepet pas nënshkrimit të kontratës nëpërmjet një Urdhri Administrativ.

- e. Datën e përfundimit të zbatimit të kontratës, duke përfshirë çdo ndryshim;

Kjo është data e fundit kur mund të ketë kosto të pranueshme. Kjo nuk përfshin asnjë periudhë garancie ose kohën e lejuar për përgatitjen e raportit nga kontraktuesi.

- f. Totali i paguar (me lekë në dorë) nga kontrata;
- g. Parafinancimi i paguar sipas kontratës;

Njohje e hollësishme dhe regjistrim në bilancin e kërkuar sipas kontratës së para-financimit.

h. Kosto e njohur - e drejtpërdrejtë (sipas kontratës);

Njohje e hollësishme e kostos si një detyrim për shpenzimet e vitit. Disa pagesa do të mbulojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë shpenzimet e kryera. Nuk përfshihet ndonjë para-financim. Këto mund të jenë pagesa përfundimtare kur para-financimi është hequr tashmë ose pagesa të ndërmjetme kur para-financimi është hequr ose kur kontrata nuk përfshin sigurimin e para-financimit.

i. Kosto e njohur – e tërthortë (sipas kontratës);

Njohje e hollësishme e kostos si një detyrim për shpenzimet e vitit. Disa fatura apo detyrime kostoje, të paraqitura nga një përfitues i grantit ose kontraktues, do të lidhen me kostot që mbulohen nga para-financimi i paguar më herët gjatë periudhës së zbatimit të marrëveshjes ose kontratës së grantit. Në këto raste, pagesa e bërë do të jetë më e vogël sesa kostoja e raportuar. Ajo mund të jetë dhe zero, nëse e gjithë kostoja është e mbuluar me para-financim (sigurisht do të jetë zero në qoftë se kostot e raportuara janë të pamjaftueshme për të thithur para-financimin dhe lëshohet një urdhër rivlerësimi për bilancin e papërdorur të para-financimit.). Në të gjitha këto raste, sistemi gjatë përcaktimit të shumës për t'u paguar, duhet të regjistrojë vlerën e plotë të kostos së pranueshme të raportuar si shpenzime për vitin dhe të reduktojë nga bilanci i para-financimit koston e kompensuar nga para-financimi.

j. Kthimi i fondeve të papërdorura për të ulur para-financimin (sipas kontratës);

Njohja e reduktimit të fondeve të para-financimit në bilanc pas kthimit të një para-financimi të papërdorur.

k. Kthimi i fondeve të papërdorura për të ulur koston (sipas kontratës);

Kur një kthim fondesh bëhet kundrejt një kostoje të pranuar më parë - ndoshta pas një hetimi për mashtrim. Në raste të tilla, shpenzimet e regjistruara për vitin duhet të reduktohen në qoftë se kostoja është pranuar në të njëjtin vit si rikuperimi pasues; ose të ardhurat duhet të regjistrohen kur kostoja është pranuar, në një vit para tij të kthimit të fondeve.

l. Data e faturës së furnizuesit për çdo faturë, ose dokument tjetër i shoqëruar nga një raport financiar që paraqet shpenzimet e njohura;

m. Informacion mbi kontekstin e kthimit të fondeve të kostove të papranueshme dhe kthimeve të fondeve.